**KËRKESË**
**Nr. 5317, datë 29.9.2016**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i shkollës "Kosova"", Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni pronarët, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 165, 312, 977 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
**Alfred Dalipi**

Llogaritjet paraprake për pasuritë që preken nga projekti "Ndërtimi i Shkollës "Kosova".

| Nr | EMER MBIEMER | Zona Kadast. | NR. Pasurisë | SIP. Tr. të prekur (m²) | Çmimi Truallit lek/m² | SIP. Obj. të prekur (m²) | Çmimi Obj.lek/m² | Vlera në lekë | Konfirmimi i ZVRPP, Tiranë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Bashkpron. Grabocka, Kapo, Zera. | 8160 | 2/76 | 2468,5 | 66,969 | 145 | 0 | 165,312,977 | Shkr.nr.prot.9049/1,dt.18.04.16<br>Shkr. nr.prot.9049/3, dt.06.06.16 |
| | | | | | | | Shuma | 165,312,977 | lekë |

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.
2. Për ndërtesat, vlerësimi është bërë sipas VKM nr.138, dt.23.03.2000 (i ndryshuar) dhe sipas çmimeve të EKB, për vitin e ndërtimit dhe amortizimin referoju faqes në vijim.